

# KUVEND, I CILI NGRITI DHE FORCOI VETËDIJEN KOMBËTARE DHE FETARE TEK SHQIPTARËT

Me 15 të këtij muaji në organizim të shoqatës kristiane-shqiptare "Kuvendi i Arbnit 1703" dhe të "Misionit Katolik Shqiptar" me seli në Shtrugart u mbajt një solemnitet përkatimor me rastin e 300-vjetorit të këtij Kuvendi, si dhe në 8-vjetorin e themelimit të Shoqatës Kristiane-shqiptare me seli në Ludwigshafen. Kishin ardhur për të marrë pjesë në këtë eveniment fetar dhe kombëtar mysafirë të shqiptar nga diaspora dhe vendndilja, siç ishin Monsinjori Zef Gashi-kryepeshkëp i Diocëzës së Tivrit, Mali i Zi, z. Faud Nimanit, kryetar i komunës së Ulqinit, Pater Anton Nua, udhëheqës i Misionit Katolik në Shtrugart, Don Fran Markiqi, Stephan Lipsius-poliolog dhe ekspert për Evropën Juglindore, Landheizer-përfaqësues i kishës katolike në Lu, Dedë Hajdari-kryetar i Unionit Demokristian në Zvicër, zori Naim Kelmendi, veprimtari i dalluar Idriz Zeciraj, z. Fazli Hajdaraj, veprimtari LDK në Gjermani, skulptori Malë Myrtaj, Feriz Laska si dhe mysafirë dhe bashkëkoharë të shumtë.

Programin e këtij përjetori e udhëhoqi znj. Vjollca Staro, e cila sipas rradhës së pari ia dha fjalën Pater Anton Nua, i cili foli për historikun e Misionit Katolik shqiptar në Shtrugart. Duke folur për migrimet e shqiptarëve ndër shekuj, sidomos për ekzodin e fundit të shqiptarëve të Kosovës, të cilët me dhunë u detyruan që t'i lëshojnë varrat e veta, tha se duke e parë këtë tragjedi Kisha Katolike Shqiptare ndjeu nevojën që t'u dalë në ndihmë dhe të kujdeset edhe për mërgimtarët tanë në Gjermani, vecanërisht që mos ta humbin gjëbënë kulturën dhe



traditën kombëtare dhe fetare. Misioni Katolik Shqiptar në Shtrugart është themeluar në vitin 1984, për të cilin që në fillim kujtojmë z. Pjetër Mjeda-teolog, i cili ka dhënë një kontribut të cësuar për bashkimin e mërgimtarëve tanë në drejtin të ruajtjes së traditave kombëtare dhe fetare në mesin e mërgimtarëve. Në Gjermani kisha shqiptare ka rënë qendra, dhe detyra e parë e tyre është që mërgimtarët ta ruajnë identitetin e tyre kombëtar dhe fetar. Në vazhdim fjalën e mori

Monsinjori Zef Gashi, i cili në veçanti përshëndeti prezencën në këtë tubim të kryetarit të Komunës së Ulqinit z. Faud Nimanit, organizatorin e këtij manifestimi, si dhe të gjithë në prani. Në fjalë të rrej të thukta ai foli për planet e lëshimit të Shqipërisë dhe aktivitetet e organizuara fetare gjatë këtij viti, i shpallur nga Papa Gjon Pali i Dytë, si vit jubilar në

shprehje të 300-vjetorit të Kuvendit të Arbnit. Ai tha se deri më tani janë mbajtur disa simpoziume shkencore, si ai në Tiranë ku u zbulua pllaka përkatimore dhe u bë promovimi i librit "Kuvendi i Arbnit 1703", me një pjesëmarr-

Në vazhdim morra Klara Curri foli rreth biografisë dhe veprimtarisë së Nenes Teresë. Me pastaj fjalë ia dha kryetarit të komunës së Ulqinit z. Faud Nimanit, i cili të përshëndeti me sllili përshëndetjet e ngrohta nga të



Zonja Krenare Canbega recitoi vargje të Çajupit për Skënderbeun, ndërsa veprimtari Idriz Zeciraj foli për martirizimin e katërdhjetë ipeshkëvizit katolik në Shqipëri gjatë kohës së diktaturës komuniste të cilët u aderruan me një minutë heshtje nga të pranishmit.

Në vazhdim fjalën e mori z. Dedë Hajdari, kryetar i UDKSH për Zvicër, i cili i emocionuar falënderoi organizatorin për këtë shënim jubilar, duke vlerësuar në veçanti rolin dhe kontributin e Monsinjori Zef Gashi në forcimin e kishës katolike në Mal të Zi, e cila luaj rol të veçantë në pengimin e asimilimit dhe të shpërnguljes së shqiptarëve nga këto treva etnike.

Rreth përmbajtjes dhe ecurisë së marrëdhënieve shqiptaro-gjermane foli z. Stephan Lipsius, poliolog dhe ekspert për Evropën Juglindore, i cili ndër të tjera veçoi se marrëdhëniet midis dy popujve tanë kanë kaluar nëpër fazë të ndryshme të rënies dhe ngritjes së tyre, me përjashtim të një numri të vogël të inteligjencës gjermane, opinioni gjerman ka qenë shumë pak i informuar mbi kulturën dhe identitetin kombëtar të shqiptarëve, dhe këshat gjendjeje të krijuar në marrëdhëniet midis dy popujve i ka ndihmuar 50 vjeçari i izolimit komunist të Shqipërisë nga bota e civilizuar.

Qeveria gjermane ka qenë gjithnjë e interesuar për përparimin e marrëdhënieve me popullin shqiptar, siç ishte iniciativa në vitin 1986 që të vihen kontaktet e para me regjimin e Tiranës, që menjëherë pas rënies së komunistit, ato të ngriten në nivel të marrëdhënieve diplomatike. Gjatë kohës së Kosovës, tha me tej të vlerësonte opinionin gjerman nëpërmjet mediave të informohet me për së afërmi për problemet e shqiptarëve në Ballkan, dhe sidomos lufta në vitin 1998-99 beri që shqiptarët si komb të



dalin në krye të mediave gjermane. Gjermania pranoi një numër të madh të rrugëtyrëve të luftës ndërsa Kosovës i ofroi ndihmë të mëdha humanitare. Mjerisht tani katër vjet pas mbarrimit të luftës, marrëdhëniet midis dy popujve tanë kanë rënë në shkallën më të ulët në aspektin politik, ushtarak, ekonomik, kulturor, i cili vë në pikëpyetje të pakta kontaktet dhe takimet midis zyrtarëve të të dy popujve, në planin e investimeve nuk ka asnjë projekt të madh, me përjashtim të disa projekteve të vogla dhe po ta shfletoni sot shtypin gjerman, do të shihet se shqiptarët dhe çështja e Kosovës janë shumë pak të pranishme në këto media.

Zoti Sadullah Mehmeti, në emër të bashkësisë Islame të Ludwigshafenit, përshëndeti organizatorin dhe të pranishmit duke i uruar sukses në punë. Skulptori Malë Myrtaj në emër të KASH-it për Gjermani përshëndeti të pranishmit dhe në fjalën e tij foli për rëndësinë gjybsore, kulturore dhe edukative të "Kuvendit të Arbnit 1703" për brezat e rinj, i cili vë e vëç vuri në dukje rolin e shkollës shqipe që nga Kuvendi i Arbnit dhe deri më sot, filluar nga Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani, Lekë Matrënga etj.

Ai gjithashtu tha se shkollat shqipe në diasporë ka pasur një rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe ngritjen e ndërgjegjes kombëtare dhe në ruajtjen e asimilimit të tyre në këto hapësira migruese. Gjybsën, kulturën dhe traditën kombëtare me mërgimtarët i ruajmë me fanatizmin dhe dinjitetin në të madh, duke iu referuar vargjeve të Naimit tonë të madh, "Gjybsët e huaja mëso, se për të ke nevojë, kurse

gjybsën tënde gjithmonë ta mbashin për zotje". I riu Emanuel Spaci recitoi vjershën e Gjergj Fishtës për gjuhën shqipe. Zoti Nikollë Shaban, organizator dhe mikpritës i këtij manifestimi, pasi që të pranishmit i ngjoi për aktivitetin pesëvjeçar të shoqatës kristiane-shqiptare "Kuvendi i Arbnit 1703", Monsinjori Zef Gashi dhe z. Faud Nimanit u dhuroi nga një bust skulpturë të luftëtarit të UCK-së, pastaj veprimtari Idriz Zeciraj, poeti Naim Kelmendi dhe z. Landheizer u dhuroi nga një libër për Kuvendin e Arbnit. Ishte cast mjaft emocionuese, kur zonja F. Hasani 70-vjeçare, Monsinjori Zef Gashi ia dhuroi një punim dorë të nenes shqiptare me veshje tradicionale shqiptare.



Ketij manifestimi telegrafane përshëndetëse i arritën nga profesor Nikë Ukeglini nga shoqata adhetare "Don Filipaj", nga Naim dhe Saim Flamuri, Sander Morini (ShBA), Anton Zakocit-Ulqin, ndërsa nga miqtë gjermanë nga doktor Eva Looz, kryetare e komunës së Ludwigshafenit, dr. Babalocky-dekan i kishës katolike në Ludwigshafen, Fritze Heizer-Ent Social, znj. Silke Schade-Ent për të Huaj etj.

Në fund të këtij manifestimi në kishën Sent Ludwig të qytetit u mbajt mesha në gjuhën shqipe e presiduar nga kryepeshkëpi Monsinjori Zef Gashi, prifti Langhäuser dhe pater Anton Nua, nga misioni katolik shqiptar në Shtrugart.

Tokë dhe foto: Ruzhë Elmeti

Pushimet verore po ofrohen Hoteli "Panorama" - Long Beach Plazhi i Madh - Ulqin - Mali i Zi. Në afër shërbime kualitative dhe çmime të volitshme. Rezervimet mund t'i bëni në Ulqin. Tel: 00381-69-331-684 në Zvicër 076-384-99-75 dhe 01-721-13-61. Në mirëpretje familja Hashi Brahim.